REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| | | | |
|---|---|---|---|
| Pranuar / Dorëzuar | 24.01 | 2024 | 4 |
| SKIMSHC | 449/2024 | | 1/6 |

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

# KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
# NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
# INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

**A.nr.341/2023**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtar, me Sabile Avdyli - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses,në lidhje me A.nr.341/2023 të datës 09.02.2023 e ankueses Emine Syla të bashkuar me ankesat tjera sipas vendimit të kryetarit të Këshillit te Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Nr.VK/2023 të datës 16.02.2023 kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme/Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike *"Transferim"*, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1,nenin 16 paragrafi 3,nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën e mbajtur me datë 24.01.2024, mori këtë:

## V E N D I M

**Përfundon procedimi administrativ** i iniciuar sipas ankesës A.nr.341/2023 të datës 09.02.2023 të ankueses Emine Syla të bashkuar me ankesat tjera sipas vendimit të kryetarit të Këshillit te Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Nr.VK/2023 të datës 16.02.2023.

## Arsyetim

Ankuesit/et, kanë parashtruar ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në çështjen juridike *"Transferim"*, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme/Administrata Tatimore e Kosovës dhe at ankuesja Emine Syla sipas ankesës A.nr.341/2023 të datës 09.02.2023 të bashkuar me ankesat A.nr.1236/2022 të ankuesit Nahit Sharku, ankesës A.nr.1237/2022 të ankuesit Hamdi Hoxha, ankesës A.nr.1238/2022 të ankuesit Bashkim Shala, ankesës A.nr.1250/2022 të ankuesit Alban Qerimi, ankesës A.nr.23/2023 të ankuesit Skënder Krasniqi, ankesës A.nr.38/2023 të ankuesit Safet Krasniqi, ankesës A.nr.48/2023 të ankuesit Ramadan Kryeziu, ankesës A.nr.49/2023 të ankuesit Hamit Mulaj, ankesës A.nr.68/2023 të ankuesit Fehmi Veselaj, ankesës A.nr.72/2023 të ankuesit Fadil Gashi, ankesës A.nr.89/2023 të ankuesit Lulzim Kelmendi, ankesës A.nr.121/2023 të ankuesit Sylejman Haxhiu, ankesës A.nr.122/2023 të ankuesit Azem Xhuzi, ankesës A.nr.124/2023 të ankuesit Shpetim Gashi, ankesës A.nr.125/2023 të ankuesit Agron Thaqi, ankesës A.nr.126/2023 të ankuesit Enver Sele, ankesës A.nr.127/2023 të ankuesit Durak Jahaj, ankesës A.nr.128/2023 të ankueses Rabije Verdani, ankesës A.nr.129/2023 të ankuesit Rahim Sahiti, ankesës A.nr.130/2023 ankesës A.nr.130/2023 të ankuesit Shyqeri Gashi, ankesës A.nr.138/2023 të ankueses Djellza Ademaj, ankesës A.nr.139/2023 të ankueses Nazmije

Krasniqi, ankesës A.nr.141/2023 të ankuesit Sadik Hasani, ankesës A.nr.143/2023 të ankuesit Hasan Veliu, ankesës A.nr.144/2023 të ankuesit Mustafë Ademaj, ankesës A.nr.145/2023 të ankueses Shefkije Morina, ankesës A.nr.146/2023 të ankuesit Petrit Xani, ankesës A.nr.147/2023 të ankuesit Genc Osmani, ankesës A.nr.149/2023 të ankuesit Bekim Redza, ankesës A.nr.150/2023 të ankuesit Selman Hoxha, ankesës A.nr.155/2023 të ankuesit Mehmet Nimani, ankesës A.nr.156/2023 të ankuesit Mehdi Fazliu, ankesës A.nr.157/2023 të ankuesit Përparim Hoti, ankesës A.nr.158/2023 të ankuesit Kujtim Isa, ankesës A.nr.164/2023 të ankueses Mevlude Hajdini, ankesës A.nr.167/2023 të ankuesit Ilir Krasniqi, ankesës A.nr.168/2023 të ankueses Herolinda Selimaj, ankesës A.nr.169/2023 të ankuesit Asdren Zaiti, ankesës A.nr.170/2023 të ankuesit Gëzim Shala, ankesës A.nr.171/2023 të ankuesit Alban Kupina, ankesës A.nr.172/2023 të ankuesit Nesim Bajrami, ankesës A.nr.173/2023 të ankueses Nafije Gashi, ankesës A.nr.174/2023 të ankuesit Burim Meholli, ankesës A.nr.175/2023 të ankuesit Naxhat Hamzaj, ankesës A.nr.176/2023 të ankuesit Xhemajl Shala, ankesës A.nr.177/2023 të ankuesit Baton Çollakaj, ankesës A.nr.178/2023 të ankueses Miradije Gorani, ankesës A.nr.179/2023 të ankueses Bukurije Shabani, ankesës A.nr.180/2023 të ankueses Valbona Hasani, ankesës A.nr.181/2023 të ankueses Ardita Kika, ankesës A.nr.182/2023 të ankueses Gentiana Ahmeti, ankesës A.nr.183/2023 të ankueses Jehonë Shala, ankesës A.nr.185/2023 të ankueses Mehreme Lutolli, ankesës A.nr.186/2023 të ankuesit Pajtim Grainca, ankesës A.nr.187/2023 të ankuesit Adem Hoti, ankesës A.nr.188/2023 të ankuesit Rexhep Koca, ankesës A.nr.189/2023 të ankuesit Fatmir Maloku, ankesës A.nr.190/2023 të ankuesit Valdrin Naili, ankesës A.nr.191/2023 të ankuesit Xhevdet Mrasori, ankesës A.nr.192/2023 të ankuesit Ndriqim Qerkini, ankesës A.nr.193/2023 të ankueses Ermira Meqikukiq, ankesës A.nr.194/2023 të ankueses Shirin Abazgjik, ankesës A.nr.196/2023 të ankuesit Besim Muqolli, ankesës A.nr.197/2023 të ankuesit Ismet Blaku, ankesës A.nr.198/2023 të ankuesit Remzi Zebica, ankesës A.nr.199/2023 të ankueses Elvira Osmanaj, ankesës A.nr.200/2023 të ankueses Marigona Franku, ankesës A.nr.201/2023 të ankuesit Adil Kryeziu, ankesës A.nr.202/2023 të ankuesit Petrit Rexha, ankesës A.nr.203/2023 të ankueses Shqipe Surdulli, ankesës A.nr.204/2023 të ankueses Hajrije Shkodra, ankesës A.nr.205/2023 të ankuesit Besnik Binakaj, ankesës A.nr.206/2023 të ankuesit Fatmir Morina, ankesës A.nr.207/2023 të ankuesit Sejdi Sadiku, ankesës A.nr.208/2023 të ankueses Shqipe Ratkoceri, ankesës A.nr.209/2023 të ankuesit Ragip Avdullahu, ankesës A.nr.210/2023 të ankuesit Veton Vishaj, ankesës A.nr.211/2023 të ankuesit Labinot Ahmeti, ankesës A.nr.212/2023 të ankuesit Hasan Llukaj, ankesës A.nr.213/2023 të ankuesit Xhemë Shala, ankesës A.nr.215/2023 të ankuesit Valdet Shala, ankesës A.nr.216/2023 të ankuesit Faredin Sylaj, ankesës A.nr.219/2023 të ankueses Edonë Gërbeshi, ankesës A.nr.220/2023 të parashtruar nga grup ankuesish (Mirsad Imeri, Qazim Mustafa, Shaqir Sejdiu, Albulena Tahiri Kelmendi, Bajram Tupella), ankesës A.nr.221/2023 të ankueses Dritë Gashi, ankesës A.nr.222/2023 të ankueses Bahtije Vllasa, ankesës A.nr.223/2023 të ankuesit Ruzhdi Hamza, ankesës A.nr.224/2023 të ankueses Dafinë Berisha, ankesës A.nr.225/2023 të ankueses Mikreme Salihu, ankesës A.nr.227/2023 të ankueses Diana Nallbani, ankesës A.nr.228/2023 të ankueses Lirije Zhushi, ankesës A.nr.229/2023 të ankueses Nafije Mazrrekaj, ankesës A.nr.230/2023 të ankuesit Kemajl Ismajli, ankesës A.nr.231/2023 të ankuesit Besim Gashi, ankesës A.nr.232/2023 të ankueses Aferditë Uka, ankesës A.nr.233/2023 të ankueses Shehide Avdiu, ankesës A.nr.234/2023 të ankuesit Enver Hyseni, ankesës A.nr.235/2023 të ankuesit Afrim Berisha, ankesës A.nr.236/2023 të ankuesit Arsim Maxhuni, ankesës A.nr.237/2023 të ankuesit Kasem Temaj, ankesës A.nr.238/2023 të ankuesit Reshat Halitjaha, ankesës A.nr.239/2023 të ankuesit Arsim Lika, ankesës A.nr.240/2023 të ankuesit Halim Rexhepi, ankesës A.nr.241/2023 të ankuesit Muhamet Grainca, ankesës A.nr.242/2023 të ankuesit Enver Sylejmani, ankesës A.nr.243/2023 të ankuesit Hajni Kurtaj, ankesës A.nr.244/2023 të ankuesit Shemsi Bojku, ankesës A.nr.245/2023 të ankuesit Afrim Sojeva, ankesës A.nr.246/2023 të ankuesit Agim Lubishtani, ankesës A.nr.248/2023 të ankuesit Adil Paqarizi, ankesës A.nr.249/2023 të ankueses Xhemile Gashi, ankesës A.nr.250/2023 të ankueses Arjana Zhubi, ankesës A.nr.251/2023 të ankueses Altina Paqarizi, ankesës A.nr.253/2023 të ankuesit Mentor

Qollakaj, ankesës A.nr.254/2023 të ankuesit Fatmir Rexhaj, ankesës A.nr.255/2023 të ankuesit Adnan Sejdiu, ankesës A.nr.256/2023 të ankuesit Martin Shkoreti, ankesës A.nr.257/2023 të ankueses Lumnije Maxhara, ankesës A.nr.258/2023 të ankuesit Shemsi Shala, ankesës A.nr.259/2023 të ankuesit Bekim Bilalli, ankesës A.nr.260/2023 të ankuesit Afrim Tahiri, ankesës A.nr.261/2023 të ankuesit Ahmet Hasani, ankesës A.nr.262/2023 të ankueses Luljeta Lushaku, ankesës A.nr.263/2023 të ankueses Afërdita Ahmeti, ankesës A.nr.264/2023 të ankueses Violeta Jonuzi, ankesës A.nr.269/2023 të ankueses Ilona Mrasori, ankesës A.nr.270/2023 të ankueses Emine Nikqi, ankesës A.nr.271/2023 të ankuesit Bashkim Paqarizi, ankesës A.nr.272/2023 të ankueses Lisjeta Krasniqi, ankesës A.nr.273/2023 të ankueses Fjolla Pula, ankesës A.nr.274/2023 të ankueses Nazmije Qoqaj, ankesës A.nr.275/2023 të ankueses Adelina Sutaj, ankesës A.nr.276/2023 të ankuesit Beqir Gashi, ankesës A.nr.281/2023 të ankuesit Shefket Vranovci, ankesës A.nr.283/2023 të ankueses Albina Sekiraqa, ankesës A.nr.284/2023 të ankueses Leonora Zenelaj, ankesës A.nr.285/2023 të ankuesit Sami Fejzullahu, ankesës A.nr.286/2023 të ankuesit Hafëz Baxhaku, ankesës A.nr.290/2023 të ankuesit Kushtrim Vllasa, ankesës A.nr.298/2023 të ankuesit Sami Avdiu, ankesës A.nr.299/2023 të ankuesit Lavdim Imeri, ankesës A.nr.305/2023 të ankuesit Hilmi Halili, ankesës A.nr.306/2023 të ankueses Donjeta Ademi, ankesës A.nr.312/2023 të ankuesit Milaim Ismajli, ankesës A.nr.314/2023 të ankuesit Jeton Balaj, ankesës A.nr.317/2023 të ankueses Farushe Abdigjiku, ankesës A.nr.319/2023 të ankuesit Fatmir Sejdiu, ankesës A.nr.320/2023 të ankuesit Sabit Osmani, ankesës A.nr.321/2023 të ankuesit Skënder Fejza, ankesës A.nr.322/2023 të ankuesit Basri Sejdiu, ankesës A.nr.324/2023 të ankuesit Rasim Selimi, ankesës A.nr.325/2023 të ankuesit Driton Aliu, ankesës A.nr.328/2023 të ankueses Adriana Nixha, ankesës A.nr.329/2023 të ankuesit Skender Jashari, ankesës A.nr.330/2023 të ankueses Shehrije Gashi, ankesës A.nr.334/2023 të ankuesit Lulzim Makolli, ankesës A.nr.335/2023 të ankueses Litafete Mehmeti dhe ankesës A.nr.340/2023 të ankueses Hasime Shabanaj.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave(në tekstin e mëtejshëm Kolegji i Këshillit), duke marr parasysh faktin se gjatë kohës së shqyrtimit të këtyre ankesave përkatësisht afatit ligjor të vendimmarrjes Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konform Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nenit 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3,nenit 20 paragrafi 2, si dhe nenit 4 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenit 6 të rregullores Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publik kishte marrë vendimin VMK/2023 me Nr.Protokolli 1851/2023 datë 16/02/2023 për monitorim të jashtëzakonshëm në Administratën Tatimore të Kosovës dhe Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme në lidhje me vlerësimin e ligjshmërisë së procesit të transferimit të nëpunësve civil si pasojë e riorganizimit të brendshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, dhe si rrjedhojë kishte konstatuar se me qenë se raporti i monitorimit ka të bëjë me çështje që ndërlidhen me objektin e këtyre ankesave të cilat janë bashkuar duke u bazuar pikërisht në objektin e njëjtë, bazuar në këto rrethana, Kolegji i këshillit në mbështetje të nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *"Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: "çështje paraprake"), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit"*, dhe ndërlidhur me Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përkatësisht nenin 20 paragrafi 3,4 dhe 5 i cili parasheh: *''3.Anëtari i Këshillit është i obliguar që të paraqet raportin me të gjetura dhe rekomandime në mbledhjen e Këshillit dhe të jep sqarime për të gjitha çështjet e ngritura nga Këshilli,4.Këshilli, pas shqyrtimit të raportit nxjerr vendim, të cilin së bashku me raportin ia dërgon institucionit përkatës,5.Institucioni përkatës i administratës publike është i obliguar për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit, brenda afatit të përcaktuar me vendimin e*

*Këshillit''*, kishte konstatuar se bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ishin plotësuar kushtet për Pezullim të procedurës në lidhje me ankesën A.nr.341/2023 të datës 09.02.2023 të ankueses Emine Syla të bashkuar me ankesat tjera sipas vendimit të kryetarit të Këshillit te Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Nr.VK/2023 të datës 16.02.2023, duke nxjerrë vendimin A.nr.341/2023 të datës 24.03.2023.

Kolegji i këshillit në arsyetim të vendimit A.nr.341/2023 të datës 24.03.2023,kishte konstatuar se procedura në lidhje me vendimmarrjen lidhur me ankesën A.nr.341/2023 të datës 09.02.2023 të ankueses Emine Syla të bashkuar me ankesat tjera sipas vendimit të kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Nr.VK/2023 të datës 16.02.2023, do të mbetet e pezulluar deri në vendosjen përfundimtare të kësaj çështje nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në vendimin VMK/2023 me Nr.Protokolli 1851/2023 datë 16/02/2023 për monitorim të jashtëzakonshëm në Administratën Tatimore të Kosovës dhe Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Kolegji i Këshillit ndërlidhur me arsyetimin si më lartë konstaton se janë plotësuar kushtet për aktivizim të kësaj lënde për faktin se tashmë nga Këshilli është vendosë në lidhje me këtë çështje përkatësisht më datë 23.01.2024,Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka aprovuar raportin e monitorimit të jashtëzakonshëm në ATK, me që rast ka nxjerrë rekomandime bazuar në këto raporte:

*1.Raportin me numër reference KR/ATK-08/2022 të datës 05.12.2022 lidhur me sistematizimin e nëpunësve civil në pozita të nivelit të mesëm drejtues dhe nivelin e ulët drejtues (drejtorë të departamenteve dhe udhëheqës të divizioneve);*
*2.Raportin me numër reference KR/ATK-09/2022 të datës 07.12.2022 lidhur me sistematizimin e nëpunësve civil në pozita të nivelit profesional; dhe*
*3.Raportin me numër reference KR/ATK/2022 të datës 03.11.2022 lidhur me sistematizimin e Udhëheqësit të Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Udhëheqësit të Divizionit të Burimeve Njerëzore.*

*Ndërsa ndërlidhur me vlerësimin e këtyre raporteve gjithnjë bazuar në legjislacionin në fuqi që rregullon këto çështje,* Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në raportin e monitorimit të jashtëzakonshëm ka konstatuar se : *Raporti me numër reference KR/ATK-08/2022 i datës 05.12.2022, gjegjësisht pika I nënpika 5; pika II nënpika 1, 2, 3; pika III nënpika 26, pika IV nënpika 6, 8 dhe 9 të këtij raporti dhe rrjedhimisht aktet administrative që derivojnë nga i njëjti janë në kundërshtim me dispozitat e nenit 54 paragrafi 3 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, si dhe dispozitat e nenit 48 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, të njëjtat vlerësohen si të paligjshme, Raporti me numër reference KR/ATK-09/2022 i datës 07.12.2022, gjegjësisht pika II nënpikat me numër rendor 1, 2, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 14,15, 17 dhe 18 të këtij raporti dhe rrjedhimisht aktet administrative që derivojnë nga i njëjti janë në kundërshtim me dispozitat e nenit 54 paragrafi 3 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, si dhe dispozitat e nenit 48 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, të njëjtat vlerësohen si të paligjshme dhe Raporti me numër reference KR/ATK-09/2022 i datës 07.12.2022, gjegjësisht pika I nënpikat me numër rendor nga 252-255, 257, 261-264, 266-269, 275-278, 280-285, 289-290, 292, 299, 301-304, 306, 309, 311-315, 317, 320-322, 326, 329-331, 333-336, 338, 340-342, 347-354, 356, 358-359, 361, 363, 368-369, 372-374, 376, 381, 383, 385-386, 390-391, 395-396, 401-404, 406, 408-409,*

*412-123, 415, 419-421, 427, 429, 431-432, 434-438, 441, 444, 448, 454, 456, 459-460, dhe 463, të këtij raporti dhe rrjedhimisht aktet administrative që derivojnë nga i njëjti janë në kundërshtim me dispozitat e nenit 54 paragrafi 3 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, Rregulloren Nr.02/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Tatimore të Kosovës, si dhe dispozitat e nenit 48 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, të njëjtat vlerësohen si të paligjshme* ,dhe ndërlidhur me këto konstatime ka nxjerrë edhe këto rekomandime:

**Rekomandimi 1:** Njësia Përgjegjëse – Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme, rekomandohet që fillimisht të rregulloj statusin e pozitës së zëvendësdrejtorëve të përgjithshëm: Bashkim Shala, Hamdi Hoxha, Nahit Sharku, dhe Hamit Mulaj, duke aplikuar kështu përshtatshmërisht dispozitat e nenit 83 ndërlidhur me nenin 42 paragrafi 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

**Rekomandimi 2**: Komisioni i Ristrukturimit bazuar në autorizimet e dhëna sipas nenit 54 paragrafi 3 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rekomandohet që në pajtim me pikëpamjet juridike të dhëna në ketë raport, në ri procedurë të përgatis raport të ri lidhur me sistemimin e nëpunësve civil të cekur si në piken I nënpika 5; piken II nënpika 1, 2, 3; piken III nënpika 26; piken IV nënpika 6, 8 dhe 9 të Raportit me numër reference KR/ATK-08/2022 të datës 05.12.2022, duke dhënë shpjegim të situatës faktike dhe shkaqeve të cilat kanë qenë vendimtare gjatë procesit të vlerësimit sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe të ndërmerr të gjitha veprimet tjera të nevojshme siç parashihet me dispozitat përkatëse të Ligjit për Zyrtarët Publikë.

**Rekomandimi 3:** Komisioni i Ristrukturimit bazuar në autorizimet e dhëna sipas nenit 54 paragrafi 3 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rekomandohet që në ri procedurë të përgatis raport të ri lidhur me sistemimin e nëpunësve civil të cekur si në piken II nënpikat me numër rendor 1, 2, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 14, 15, 17 dhe 18, të Raportit me numër reference KR/ATK-09/2022 të datës 07.12.2022, në pajtim me pikëpamjet juridike të dhëna në ketë raport, duke dhënë shpjegim të situatës faktike dhe shkaqeve të cilat kanë qenë vendimtare gjatë procesit të vlerësimit sikurse përcaktohet me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe të ndërmerr të gjitha veprimet tjera të nevojshme siç parashihet me dispozitat përkatëse të Ligjit për Zyrtaret Publikë.

**Rekomandimi 4:** Komisioni i Ristrukturimit bazuar në autorizimet e dhëna sipas nenit 54 paragrafi 3 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rekomandohet që në ri procedurë të përgatis raport të ri lidhur me sistemimin e nëpunësve civil të cekur si në piken I nënpika me numër rendor nga 252-255, 257, 261-264, 266-269, 275-278, 280-285, 289-290, 292, 299, 301-304, 306, 309, 311-315, 317, 320-322, 326, 329-331, 333-336, 338, 340-342, 347-354, 356, 358-359, 361, 363, 368-369, 372-374, 376, 381, 383, 385-386, 390-391, 395-396, 401-404, 406, 408-409, 412-123, 415, 419-421, 427, 429, 431-432, 434-438, 441, 444, 448, 454, 456, 459-460, dhe 463, 473, 477, 480, 483, 485-487, 541, 546, në pajtim me pikëpamjet juridike të dhëna në ketë raport, duke dhënë shpjegim të situatës faktike dhe shkaqeve të cilat kanë qenë vendimtare gjatë procesit të vlerësimit sikurse përcaktohet me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe të ndërmerr të gjitha veprimet tjera të nevojshme siç parashihet me dispozitat përkatëse të Ligjit për Zyrtaret Publikë.

Andaj bazuar në at që u tha si më lartë ,Kolegji i këshillit konstaton se me qenë se objekti i ankesave ka qenë i ndërlidhur me raportin e monitorimit të jashtëzakonshëm, dhe bazuar në këto rrethana,

përkatësisht konstatimet e nxjerra në përmbajtje të raportit janë trajtuar çështjet që ndërlidhen me objektin e këtyre ankesave, me që rast është konsumuar elementi i vendimmarrjes sa i përket objektit të këtyre ankesave dhe në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet ligjore për përfundim të procedimit administrativë bazuar në Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nga se në nenin 104 shprehimisht përcaktohet :*''Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objektipër të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë''.*

Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike**: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**
**Lënda, A.nr.341/2023, datë 24/01/2024**

**Sabile AVDYLI**
**Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional**

**Arben MEHMETI**
**Kryetar i Kolegjit**

**Vendimi i dërgohet:**
- Ankuesve(Shtojca e bashkangjitur e këtij vendimi)
- Drejtorit Ekzekutiv të Administratës Tatimore të Kosovës:
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK.